



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 181

Tiranë – E Enjte, 27 Nëntor 2014

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret nr. 8791, datë 17.11.2014	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 9321
Dekret nr. 8792, datë 18.11.2014	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 9321
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 759, datë 12.11.2014	Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim..... 9322
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 801, datë 26.11.2014	Për lirimimin dhe emërimin nga/në detyrë të disa anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik..... 9342
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 20, datë 17.11.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” 9342
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 21, datë 17.11.2014	Mbi procedurën e pagesave të detyrimeve e doganore të paguara tepër nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ... 9343
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 22, datë 19.11.2014	Për mbikëqyrjen e OJF-ve, nga organet tatimore, në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit 9344
Urdhër i ministrit të Mjedisit nr. 1957, datë 6.11.2014	Për miratimin e modelit të autorizimit për eksportin e mbetjeve dhe modelin e autorizimit për kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme apo inerte 9346
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 99, datë 7.11.2014	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për vitin 2015..... 9350
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 100, datë 7.11.2014	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë (KESH sh.a.) për vitin 2015..... 9351

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 101, datë 7.11.2014	Për licencimin e shoqërisë “UKKO” sh.a., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impiante fotovoltaike me fuqi 1 mW	9351
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 102, datë 7.11.2014	Për licencimin e shoqërisë “Komp.Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	9352
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë n. 103, datë 7.11.2014	Për licencimin e shoqërisë “SA’GA-Mat” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	9352
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 104, datë 7.11. 2014	Për licencimin e shoqërisë “Emikel” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	9353
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 105, datë 7.11.2014	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Le Trading Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	9353
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 106, datë 7.11.2014	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “AXPO Albania” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	9354
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 107, datë 7.11. 2014	Për fillimin e procedurave për rinovimin e licencës së shoqërisë “AXPO Albania” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 102, datë 21.12.2009.....	9355
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 108, datë 14.11.2014	Për licencimin e shoqërisë “Eft Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	9355
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 109, datë 14.11. 2014	Për licencimin e shoqërisë “Eft Albania” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike..	9356

**DEKRET****Nr. 8791, datë 17.11.2014****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Bashkim Sahit Rama
2. Diana Jemin Rama (Sadrija)
3. Ben Bashkim Rama
4. Dimitrov Llampo Popaj
5. Jasmina Vido Popović (Kontiq)
6. Predrag Vladimir Popović (Popaj)
7. Renato Zef Ndokaj
8. Etnike Ilirian Xhydollari
9. Etleva Qemal Hambrock (Shamku)
10. Pirigov Savo Ajković (Hajkoja)
11. Zore Pavo Ajković (Dimnaku)
12. Dejan (Arben) Pirigov Ajković (Hajkoja)
13. Igor (Ilir) Pirigov Ajković (Hajkoja)
14. Sllagjana Pavle Ajković (Popović)
15. Dragan Gjorgjo Ajković
16. Theodhor Vasil Tiko
17. Enkeleda Vesel Gozhdari (Belaj)
18. Ada Ismail Schulzki (Qiftja)
19. Odeta Behxhet Hoxha
20. Laura Teufik Milaqi
21. Vjosjana Skender Kacanja
22. Onisa Ilia Tanellari
23. Danica Shako Brajović (Jakoja)
24. Adriano Saša Janićijević
25. Sokol Ndue Lucaj
26. Vitore Gjergj Lucaj (Nika)
27. Rudina Bajram Mulgeci
28. Sulejman Isak Nuredinaj
29. Leonora Ali Tahiri (Kalo)
30. Kevin Shkëlqim Tahiri
31. Luan Xhabir Bytyçi
32. Migena Muharrem Dashi
33. Eris Muharrem Dashi
34. Ilir Ymet Ymeti

35. Valbona Napolon Mavros (Tasi)

36. Robert Spiro Llambro

37. Adriana Fadil Ngjelina

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET**Nr. 8792, datë 18.11.2014****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Mark Zef Gojani
2. Metë Nebi Shatri
3. Bleta Jusuf Murati (Tabaku)
4. Michaela Karl Riegler
5. Arton Hasip Krasniqi
6. Oktay Nasir Koç
7. Aldo Nicola Mazzarella
8. Hasan Halil Demircan
9. Gonca Hasan Demircan (Durukan)
10. Ayşe Mustafa Demircan (Ercan)
11. Fatbardha Xhavid Shima (Susuri)
12. Merita Halil Cani (Gashi)
13. Ghalia Omar Ketteb
14. Nihat Kuddüs Resul
15. Dilek Ekrem Resul (Karatatar)
16. Yusuf Nihat Resul
17. Dilara Nihat Resul
18. Dany Aref Tannous Makhoulouta
19. Alex Dany Makhoulouta
20. Roni Dany Makhoulouta
21. Mehmet Ahmet Arslantaş
22. Carmen-Elena Costel Vrahoriti (Matei)
23. Isa Salih Erbaş



24. Arlind Agron Basha
25. Mimoza Nesip Kaçi
26. Josif Vangjel Gorrea
27. Hüseyin Sait Tunca

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM

Nr. 759, datë 12.11.2014

PËR LICENCIMIN PROFESIONAL TË INDIVIDËVE DHE SUBJEKTEVE JURIDIKE QË DO TË USHTROJNË VEPRIMTARI NË FUSHËN E STUDIMIT E TË PROJEKTIMIT NË NDËRTIM DHE MBIKËQYRJES E KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT NË NDËRTIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, shkronja "a", e 5, pika 3, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 5, 7 e 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Çdo individ apo subjekt juridik, që kërkon të ushtrojë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, duhet të pajiset me licencën profesionale përkatëse sipas përcaktimeve të rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Krijimin e komisionit, si strukturë e posaçme administrative, që ka autoritetin e vetëm për dhënien, ndryshimin apo revokimin e licencave profesionale të individëve apo subjekteve juridike, si dhe vendosjen e penaliteteve për veprimtari në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, i cili të ketë në përbërje:

- një përfaqësues nga Kryeministria, i cili të jetë kryetar;
- dy përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit;
- një përfaqësues nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës;
- një përfaqësues nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë;
- një përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, të Universitetit Politeknik të Tiranës;
- një përfaqësues nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, i Universitetit Politeknik të Tiranës.

Detyrën e sekretariatit teknik të komisionit e ushtron struktura përkatëse për licencimin pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

3. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 412, datë 15.9.1992, "Për krijimin e komisionit të posaçëm për dhënien e licencave profesionale", e nr. 613, datë 13.12.1993, "Për ushtrimin e veprimtarisë në ndërtim dhe projektim të shoqërive", si dhe çdo akt nënligjor që bie ndesh me këtë vendim shfuqizohen.

4. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Universiteti Politeknik i Tiranës dhe komisioni i posaçëm për dhënien e licencave profesionale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE PËR INDIVIDË DHE SUBJEKTE JURIDIKE QË DO TË USHTROJNË VEPRIMTARI NË FUSHËN E STUDIMIT E TË PROJEKTIMIT NË NDËRTIM DHE MBIKËQYRJES E KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT NË NDËRTIM

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i rregullores dhe fusha e veprimit

Kjo rregullore përcakton dhe shtrinë fushën e veprimit në:



1. Organizimin dhe funksionimin e strukturave që kryejnë dhe mbështesin procesin e licencimit profesional të subjekteve në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit.

2. Kategoritë e punimeve të studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit, kushtet dhe kriteret paraprake, dokumentare dhe specifike që duhen plotësuar për t'u pajisur me licencë profesionale.

3. Të drejtat që kanë subjektet për t'u pajisur me licencë në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit, ndryshimet që u bëhen atyre dhe masat administrative për rastet e veprimeve në kundërshtim me dispozitat në fuqi, gjatë ushtrimit të aktivitetit.

Neni 2

Përkufizimi i termave

1. “Komision” - është struktura e posaçme administrative, për licencimin në Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që ka autoritetin e vetëm për dhënien apo heqjen e licencave, për subjekte që ushtrojnë veprimtarinë, në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të ndërtimit.

2. “Licencë profesionale” - dokument me të cilin pajiset çdo individ ose subjekt juridik vendas ose i huaj që dëshiron të ushtrojë profesionalisht studimin dhe/ose projektimin dhe mbikëqyrjen dhe/ose kolaudimin në fushën e ndërtimit.

3. “Vite eksperiencë” - vite pune gjithsej dokumentuar me librezë pune dhe/ose çdo dokument tjetër të barasvlershëm me të, nga momenti i diplomimit.

4. “Eksperiencë profesionale” - veprimtari profesionale në fushat respektive e dokumentuar nga ente publike apo private.

5. “Arsimi i lartë përkatës” - diplomimi master shkencor apo profesional në degën përkatëse.

6. “Diplomë” - dokumenti zyrtar i lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuar sipas dispozitave në fuqi.

7. “KTP” - kushte teknike të projektimit.

8. “Kategori” – specifikimi i llojit apo nënlojit të veprimtarisë në fushën e studimit, projektimit, mbikëqyrjes e kolaudimit.

9. “Subjekt” – në kuptim të kësaj rregulloreje është çdo individ apo shoqëri që ushtron veprimtari në fushën e studimit, projektimit, mbikëqyrjes e kolaudimit.

10. “Shoqëri”- subjekt juridik i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi për ushtrimin e veprimtarisë profesionale, studimin dhe/ose projektimin dhe mbikëqyrjen dhe/ose kolaudimin në fushën e ndërtimit.

11. “Ekspert” - specialist i licencuar i fushës përkatëse me eksperiencë të njohur e të vlerësuar.

12. “Sekretariati teknik i Komisionit” - është struktura përkatëse pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit që kryen procedurat administrative të trajtimit, vlerësimit, relatimit dhe regjistrimit të individëve dhe subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtarinë e studimit dhe/ose projektimit dhe mbikëqyrjes dhe/ose kolaudimit.

KREU II

FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE PËR DHËNIEN E LICENCAVE PROFESIONALE KOMISIONI I POSAÇËM PËR DHËNIEN E LICENCAVE PROFESIONALE

Neni 3

Krijimi – përbërja

1. Komisioni ushtron veprimtari në përpunje me këtë rregullore dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi, që përcaktojnë kriteret në këtë fushë.

2. Komisioni merr vendime për dhënie licence profesionale individuale dhe për shoqëri, shtesa dhe rinovime në licencat profesionale, ndryshime të drejtuesve të shoqërisë, kryesisht në kushtet e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 4

Komisioni i licencimit

1. Komisioni thirret në mbledhje nga Kryetari i tij.

- Si rregull ai mbledhet çdo muaj, ndërmjet datave 25 – 30.

- Me kërkesë të kryetarit të Komisionit mbledhet dhe jashtë radhe.

2. Në mbledhjen e tij të parë, Komisioni zgjedh nënkryetarin e tij.

3. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se tri të katërtat e anëtarëve të Komisionit.

Në mungesë të kryetarit dhe me autorizim të tij mbledhjet mund të drejtohen nga nënkryetari i Komisionit.



4. Në mbledhje, Komisioni shqyrton dhe vendos për kërkesat, ankesat, informacionet e paraqitura nga Sekretariati teknik, të cilat janë depozituar të paktën 4 ditë para datës së mbledhjes.

5. Mbledhjet e Komisionit janë të mbyllura dhe në to mbahet protokoll. Protokoll mbahet nga një përfaqësues i Sekretariatit teknik të Komisionit ose përfaqësues i Drejtorisë për Licencimin. Protokoll përmban të dhëna, të paktën për pjesëmarrjen, diskutimet, votimin dhe nënshkrimet e pjesëmarrësve.

6. Kryetari i Komisionit vendos për praktikën e përgatitura nga Sekretariati Teknik që lidhen me kërkesa të subjekteve të karakterit formal, si vijon:

- Ndryshim dhe shtesë në drejtuesit ligjor të Shoqërisë;
- Ndryshim emërtim shoqërie;
- Ndryshim i selisë së shoqërisë;
- Lëshim i dublikatës.

Mbyllja e aktivitetit të shoqërisë, çregjistrim i tyre.

Neni 5

Përgatitja e materialeve për Komision

1. Rendi i ditës për mbledhjen e radhës të Komisionit hartohet nga Sekretariati teknik dhe miratohet nga kryetari i Komisionit.

2. Komisioni shqyrton materiale që kanë të bëjnë me licencimin e individëve apo shoqërive, ankesa të tyre për vendimet pararendëse, informacione e kërkesa të enteve publike apo private, përfundime dhe raporte nga kontrollet e kryera.

3. Materialet që do të shqyrtohen në mbledhje u shpërndahen anëtarëve të Komisionit nga Sekretariati teknik jo më vonë se tre ditë para datës së caktuar për mbledhje.

4. Materialet përgatiten nga sekretariati teknik dhe nënshkruhen nga përgjegjësi i sektorit respektiv dhe përpunuesit e tij.

Neni 6

Ekspertët

1. Për çështje që do të shqyrtohen, të cilat kanë nevojë për verifikim dhe informacion të mëtejshëm, caktohen ekspertë. Çdo grup ekspertësh drejtohet nga një anëtar Komisioni.

2. Ekspertët përzgjidhen nga drejtori i drejtorisë përgjegjëse për licencimin dhe miratohen me urdhër të Kryetarit të Komisionit brenda datës 15 të muajit.

Faqe | 9324

3. Ekspertiza e përgatitur me shkrim dorëzohet në Drejtorinë e Licencimit jo më vonë se data 25 e muajit vijues. Ekspertët për punën e kryer shpërblehen me urdhër të kryetarit të Komisionit.

Neni 7

Marrja e vendimeve

Komisioni merr vendim jo më vonë se 35 ditë nga dorëzimi i dokumenteve për licencim pranë sekretariatit teknik.

Neni 8

1. Vendimet në Komision si rregull merren me konsensus; kur ky nuk arrihet merret me shumicën e votave të anëtarëve pjesëmarrës.

- Në rastet kur votimi rezulton i barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

2. Vendimet e Komisionit hartohen nën përgjegjësinë e sekretariatit teknik, dhe nënshkruhen nga kryetari dhe anëtarët e Komisionit që kanë qenë pjesëmarrës në mbledhje.

- Vendimet e Komisionit përgatiten në tre kopje: njëra dorëzohet në zyrën e arkiv dokumentacionit, tjetra në sekretariatin teknik, për veprime të mëtejshme dhe e treta në praktikën e Komisionit që disponohet nga kryetari i Komisionit.

SEKRETARIATI TEKNIK

Neni 9

Sekretariatit teknik i Komisionit është organizuar dhe funksionon pranë Drejtorisë përgjegjëse për licencimin pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

Organizimi i sekretariatit bëhet në bazë e zbatim të strukturës organizative të Ministrisë dhe veprimtaria e tij zhvillohet në përputhje me rregulloren e brendshme të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe këtë rregullore.

Neni 10

Dorëzimi dhe pranimi i kërkesave

1. Kërkesa për licencë dhe dokumentet shoqërues të saj sipas kësaj rregulloreje, dërgohen me postë rekomande.

- Dokumentet për licencë duhet të jenë të daktilografuara, origjinale ose fotokopje të noterizuara.

- Dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer nga përkthyes të licencuar në gjuhën shqipe.



- Në faqen e jashtme të zarfit që mban adresën e plotë të subjektit kërkuar, nënshkrimin dhe vulën e tij, dhe adresa e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

2. Zarfet e mbyllura tërhiqen çdo ditë nga përgjegjësi i sektorit përkatës për licencimin dhe regjistrohen në protokollin e posaçëm të Sektorit të shoqëruara me kartelë.

3. Në kartelën shoqëruese evidentohen shënime në lidhje me përputhshmërinë e dokumentacionit të aplikimit me kërkesat e kësaj rregulloreje. Kartela nënshkruhet nga punonjësit që trajtojnë aplikimin dhe japin mendim për kërkesën deri në vendimin e Komisionit.

- Mendimi i sektorit në materialin që i paraqitet Komisionit bazohet në këtë kartelë.

4. Çdo kërkesë shqyrtohet paraprakisht brenda ditës, në se përmban të plotë e të saktë gjithë dokumentacionin përkatës sipas kësaj rregulloreje.

- Kërkesat që pas shqyrtimit rezultojnë të parregullta, nënshkruhen pas motivimit nga pranuesi, dhe njoftohet brenda një dite për mangësitë, subjekti aplikues me shkresë zyrtare /njoftime verbale/postë elektronike/telefon.

Neni 11

Shqyrtimi i kërkesave

Çdo kërkesë e pranuar:

- I nënshtrohet oponencës së specialistit në se ajo është në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

- Shoqërohet detyrimisht me mendimin e motivuar e të nënshkruar të specialistit dhe Përgjegjësit të sektorit në kartelën shoqëruese të kërkesës.

Neni 12

Ruajtja dhe arkivimi

1. Sekretariati teknik, mbi bazën e vendimit të Komisionit, përgatit formularët e licencave në dy kopje origjinale.

- Njëra prej të cilave pas nënshkrimit nga Kryetari, i dorëzohet subjektit përkatës e vulosur, ndërsa tjetra, e nënshkruar edhe nga hartuesit, ruhet për arkivim.

2. Licencat profesionale janë dokumente me vlerë që i nënshtrohen prodhimit të posaçëm dhe kontrollit të rreptë.

- Format i tyre propozohet nga Komisioni dhe miratohet nga Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

3. Sekretariati Teknik përgjigjet për arkivimin sipas rregullave në fuqi të Licencës, dokumentacionit, kërkesës dhe mandatit të arkëtimit për pagesën sipas tarifës përkatëse.

4. Tarifat për personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj, që licencohen janë sipas lidhjes nr. 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 13

Bashkëpunimi me entet publike apo private

Sekretariati teknik nëpërmjet strukturës organizative të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, mban lidhje të qëndrueshme me institucionet e administratës shtetërore. Ai:

- kërkon, pranon dhe u jep atyre zyrtarisht informacion për subjektet që licencohen pranë tij, apo për raste të veçanta kur kërkojnë të licencohen;

- trajton dhe u kthen zyrtarisht përgjigje ankesave apo propozimeve të tyre.

Sekretariati teknik ka për detyrë të informojë çdo kërkuar, në lidhje me:

- Kërkesat e përgjithshme dhe specifike që nevojiten për të aplikuar për licencë.

- Përputhshmërinë e dokumentacionit në lidhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

- Ecurinë e aplikimit të tij për licencë.

- Të dhëna në lidhje me individë apo shoqëri të licencuara, për rastet kur kërkuar vërteton se është i përfshirë në procese ligjore me subjektin për të cilin kërkon informacion.

Neni 14

Veprime drejtpërdrejt nga Sekretariati teknik pa pasur nevojë për të kaluar në Komision

1. Sekretariati teknik ka të drejtë të kryejë çdo ditë veprime, pa kaluar në trajtimin nga Komisioni, për rastet e parashikuara në nenin 4, pika 6 të kësaj rregulloreje, mbështetur në dokumentacionin përkatës të paraqitur në zbatim të kësaj rregulloreje.

2. Për çdo rast të tillë paraqitet kërkesë me shkrim dhe veprohet sipas nenet 10 dhe 11 të rregullores.

3. Vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur sipas pikës 1 shoqërohet me procesverbal të hartuar nga Sekretariati teknik, i cili së bashku me licencat respektive që pasqyrojnë ndryshimin (për rastet kur nevojitet licencë e ndryshuar), i dërgohen për nënshkrim kryetarit të Komisionit dhe ndryshimet reflektohen menjëherë në regjistrat e subjekteve të licencuar. Sekretariati teknik bën të



pavlefshme licencën profesionale origjinale që subjekti dispononte përpara ndryshimit.

Neni 15

Protokolli, regjistrat dhe arkivi

1. Sekretariati teknik harton, mban dhe përditëson protokollin, ku evidenton të gjitha kërkesat e individëve apo shoqërive për licencim.

2. Gjithashtu është përgjegjës për hartimin, përditësimin dhe publikimin e:

- Regjistrat themeltar për licencat profesionale individuale dhe shoqërive të licencuara për studim e projektim;

- Regjistrat themeltar për licencat profesionale individuale dhe shoqërive të licencuara për mbikëqyrje e kolaudim;

3. Arkivi i sekretariatit teknik, sipas mundësive, organizohet bashkë ose veças nga arkivi i Ministrisë, me urdhër të veçantë të titullarit. Në arkiv arkivohen dokumentet e plota të çdo subjekti që ka paraqitur kërkesë për t'u pajisur me licencë dhe licencën e përfutur prej tij.

KREU III

LICENCAT PROFESIONALE – KATEGORITË, ELEMENTËT DHE KUFIZIMET

Neni 16

Licenca – kategoritë e punimeve

1. Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të tij të ushtrojë veprimtari të caktuar profesionale sipas kategorive të punimeve të fituara në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim duke u mbështetur kryesisht në profilin e diplomës së arsimit të lartë, vitet e eksperiencës, eksperiencën në punë, kushtet e kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

2. Kategoritë e punimeve të studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit sipas të cilave kërkohet dhe jepen licencat profesionale, paraqiten respektivisht në lidhjet e rregullores.

Neni 17

Llojet e licencave dhe elementet e saj

1. Llojet e licencave janë:

- Licencë profesionale individuale;
- Licencë profesionale për shoqëri.

2. Licencat profesionale personale, apo për shoqëri jepen për këto veprimtari:

- Studim e projektim;

- Mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi në ndërtim.

3. Licenca përmban këta elementë:

- Të dhëna të individit apo shoqërisë disponuese.

- Kategoritë për veprimtaritë që ka të drejtë të ushtrojë disponuesi.

- Afati i vlefshmërisë për rastet e shoqërive.

- Numri i regjistrimit themeltar.

- Shenja dalluese.

- Fotografia e individit për licencat individuale.

Kategoritë e plota në fushën e studimit e projektimit (për licencat e studimit e projektimit) dhe të mbikëqyrjes se kolaudimit (për licencat e mbikëqyrjes e kolaudimit), në pjesën e prapme të formularit të licencës.

Neni 18

1. Licenca nuk lejohet të transferohet nga një individ apo shoqëri tek tjetra.

2. Kur një individ apo shoqëri, humbet licencën profesionale njofton menjëherë zyrtarisht Komisionin e posaçëm (Sekretariatit teknik) dhe pajiset me dublikatë me plotësimin e dokumenteve sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

3. Licencat individuale tërhiqen nga vetë personi i licencuar ose nga persona të autorizuar me akte noteriale për të kryer një veprim të tillë (kopja e autorizimit noterial depozitohet në dosjen që arkivohet).

4. Licencat e shoqërive tërhiqen nga drejtuesi ligjor ose persona të autorizuar me akte noteriale për të kryer një veprim të tillë (kopja e autorizimit noterial depozitohet në dosjen që arkivohet) ose nga drejtuesit teknik të shoqërisë.

5. Shoqëritë që janë pajisur me licencë të re si rezultat i ndryshimit të drejtuesve teknik, drejtuesve ligjor apo ndryshim të emrit apo selisë, përpara se të tërheqin licencën duhet të dorëzojnë origjinalin e licencës paraardhëse. Originali shënjohet nga Sekretariati teknik me prerje në anë dhe arkivohet në dosjen e subjektit pranë arkivit të sekretariatit.

6. Personat të cilët janë të pajisur me licencë për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, të cilët punësohen pranë shoqërive për zbatim të punimeve të ndërtimit, duhet të dorëzojnë kopjen origjinale të licencës së mbikëqyrjes dhe kolaudimit pranë arkivit të sekretariatit teknik. Kjo licencë i



kthehet përsëri personit në momentin që ai shkëputet nga pozicioni i drejtuesit teknik në shoqëri për zbatimin në ndërtim.

Neni 19

Kufizime në dhënien e licencave

1. Nuk lejohet të pajisen me licencë në rolin e drejtuesit teknik për shoqëri, personat që punojnë në institucionet shtetërore qendrore apo të pavarura dhe persona të tjerë, aktiviteti i të cilëve, bie ndesh me dispozitat ligjore apo nënligjore për nëpunësin civil.

2. Shoqëritë për zbatim të punimeve të ndërtimit, drejtuesit teknikë të tyre dhe specialistët e licencuar që punojnë pranë tyre nuk mund të licencohen si individë e shoqëri për mbikëqyrje e kolaudim për punë publike.

Neni 20

Afatet e vlefshmërisë së licencës

1. Afatet e vlefshmërisë së licencave nga data e lëshimit të tyre janë:

- për licencë profesionale të shoqërive për studim e projektim, sa afati i vlefshmërisë së kontratës që ka shoqëria me drejtuesin/drejtuesit teknik (kontrata me afatin e vlefshmërisë më të afërt) por jo më shumë se 5 vjet;

- për licencë profesionale të shoqërive për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit në ndërtim, sa afati i vlefshmërisë së kontratës që ka shoqëria me drejtuesin/drejtuesit teknik (kontrata me afatin e vlefshmërisë më të afërt) por jo më shumë se 10 vjet;

- licencat individuale jepen me afat të përhershëm.

2. Afati kohor minimal për të kërkuar shtesë të kategorive në licencë profesionale individuale dhe të shoqërive është jo më pak se një vit.

KREU IV

KUSHTET PARAPRAKE PËR TË FITUAR LICENCË, DETYRAT DHE TË DREJTAT E SUBJEKTEVE QË LICENCOHEN

Neni 21

1. Çdo individ apo shoqëri, vendas ose i huaj për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit, ka të drejtë të paraqesë kërkesë pranë Komisionit të posaçëm të dhënies së licencave profesionale për

t'u pajisur me licencë profesionale, pasi të ketë plotësuar kushtet që përcaktohen në këtë rregullore.

2. Kushtet dhe kriteret specifike të cilat kërkohen në përgjithësi për të fituar kategoritë e veprimtarisë në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim, jepen në vijim të kësaj rregulloreje dhe në lidhjet nr. 4 dhe nr. 5 të rregullores.

Neni 22

Kushtet paraprake për licencë profesionale individuale, janë:

1. Për studim e projektim.

- Të jetë diplomuar në nivelin master profesional apo shkencor në arsimin e lartë përkatës, pranë institucioneve të arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi apo të ketë njehsuar diplomën ekuivalente të lëshuar nga institucionet e huaja, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

- Të ketë vite eksperience në projektim, mbi 2 vjet në institucione publike projektuese, shoqëri studimi e projektimi, ose institucionet e arsimit të lartë.

2. Për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit në ndërtim

- Të jetë diplomuar në nivelin master profesional apo shkencor në arsimin e lartë përkatës, pranë institucioneve të arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi apo të ketë njehsuar diplomën ekuivalente të lëshuar nga institucionet e huaja, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

- Të ketë mbi 15 vjet eksperiencë në studime e projekte apo zbatimin në ndërtim, në profesionin përkatës;

- Të mos jetë drejtues teknik ose i punësuar në Shoqëri për zbatimin në ndërtim.

Kushtet e mësipërme paraprake, vlejné dhe për individët e huaj që kërkojnë të përfitojnë licencë profesionale.

Neni 23

Kushtet paraprake për licencë profesionale individuale e drejtuesit teknik të shoqërisë, janë:

1. Drejtuesi teknik i shoqërisë për studime e projekte, është një ose më shumë individë të pajisur me licencë profesionale individuale dhe me vite eksperiencë jo më pak se 5 vjet. Në rastin kur mesatarja e notave të shkollës së lartë për individin,



rezulton 9 ose më shumë, mund të regjistrohet drejtues teknik dhe me 3 vite eksperiencë. Individit mund të përfitojë licencën individuale njëkohësisht me vendosjen si drejtues teknik.

2. Drejtuesi Teknik i Shoqërisë për mbikëqyrje e kolaudim, është një ose më shumë individë të pajisur me licencë profesionale individuale në fushën respektive dhe me vite eksperiencë jo më pak se 15 vjet. Individit mund të përfitojë licencën individuale njëkohësisht me vendosjen si drejtues teknik.

3. Shoqëria fiton licencë profesionale mbështetur dhe në përputhje me licencën profesionale individuale të drejtuesit/drejtuesve teknikë që ajo ka, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të Komisionit për dokumentacionin e paraqitur.

4. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar me këtë cilësi në dy a më shumë Shoqëri.

5. Drejtuesi/drejtuesit teknikë duhet të jenë në marrëdhënie pune me shoqërinë për një periudhë jo më pak se një vit.

6. Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me Shoqërinë rregullohen me Kodin e Punës dhe Kontratë punësimi.

Në rastet e shoqërive të huaja që kërkojnë të përfitojnë licencë profesionale, zbatohen të njëjtat kushte dhe kritere paraprake si më sipër.

- Kur drejtuesi teknik i shoqërisë së përbashkët ose të huaj është vendas, zbatohen të njëjtat kushte paraprake si për drejtuesin teknik të shoqërisë.

- Kur drejtuesi teknik i shoqërisë së huaj ose të përbashkët, është i huaj, bëhet ekuivalentimi i licencës individuale të tij sipas përcaktimeve në këtë rregullore dhe gjithashtu zbatohen të njëjtat kushte paraprake si për shoqëritë vendase.

Neni 24

Kushtet paraprake për licencë profesionale për shoqëri, janë:

1. Për studimin e projektimit

- Të jenë regjistruar si subjekt juridik sipas dispozitave ligjore për të ushtruar veprimtari në studim e projektim.

- Të ketë drejtues teknik një ose më shumë persona fizikë të pajisur me licencë profesionale personale për studim e projektim.

2. Për mbikëqyrës punime zbatimi

- Të jenë regjistruar si subjekt juridik sipas dispozitave ligjore për të ushtruar veprimtari në mbikëqyrje e kolaudim.

- Të ketë drejtues teknik një ose më shumë persona fizikë të pajisur me licencë profesionale personale për mbikëqyrje e kolaudim.

Në rastet e shoqërive të huaja që kërkojnë të përfitojnë licencë profesionale, zbatohen të njëjtat kushte paraprake si shoqëritë vendase.

Neni 25

Detyrat e subjekteve të licencuara, janë:

1. Të njohin dhe të kryejnë veprimtari në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për studimin e projektimin dhe mbikëqyrjen e kolaudimit.

2. Të njohin e të zbatojnë standardet, kushtet teknike të projektimit, si dhe euronormat e pranuar nga vendi ynë.

3. Çdo shoqëri e licencuar nuk duhet të ushtrojë asnjë veprimtari në mungesë të drejtuesit/drejtuesve teknikë.

4. Shoqëritë duhet të kenë statusin “aktiv” të ushtrimit të veprimtarisë, dëshmuar nga dokumenti respektiv i QKR-së.

5. Drejtuesi teknik i shoqërisë detyrohet të njoftojë një muaj më parë, zyrtarisht me kërkesë të motivuar, drejtuesin ligjor për largimin nga shoqëria. Njëkohësisht duhet të paraqesë dhe pranë Komisionit të posaçëm, kërkesën /deklaratën për prishjen e kontratës, të hartuar në prani të noterit ose dokumentin zyrtar të lëshuar nga shoqëria për këtë largim.

6. Çdo largim pa arsye shoqërohet me marrjen e masës administrative kundrejt individit.

KREU V

KUSHTET DOKUMENTARE PËR PAJISJEN ME LICENCË PROFESIONALE DHE REGJISTRIMI

Neni 26

Për pajisje me licencë profesionale individuale për herë të parë

Aplikimi për pajisje me licencë individuale për herë të parë, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

- Kërkesë me shkrim të daktilogruar, ku të përcaktohen të paktën gjeneralitetet, adresa e plotë



e individit dhe kategoritë sipas zërave të punimeve me të cilat individit kërkon të Licencohet.

- Kopje të kartës së identitetit.
- Kopje të noterizuar të diplomës.
- Veprimtaria e tij e kryer nga marrja e diplomës në formën e CV.

- Dokumentacion teknik justifikues (origjinal ose kopje të noterizuar) për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma, kopje projektsh (ose pjesë të tyre) ku personi ka qenë bashkautor, certifikata kursi apo specializimi që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet.

- Vetëdeklarim i individit mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e saj KTP (kushtet teknike të projektimit), dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit. (sipas formatit të lidhjes nr. 6/1);

- Në rastet kur personi kërkon të pajiset dhe me licencë për mbikëqyrje e kolaudim punime zbatimi, personi duhet të përfshijë në vetëdeklarimin e mësipërm dhe pozicionin e tij në lidhje me punësimin në shoqëri ndërtimi (është apo nuk është i punësuar në ndonjë rol në këto shoqëri). (sipas formatit të lidhjes nr. 6/2)

- Dy fotografi për dokument të individit që kërkon të licencohet (fotografi të 3 muajve të fundit).

- Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr. 1).

Neni 27

Për pajisje me shtesa në kategoritë e licencës individuale

Aplikimi për pajisje me shtesa në licencën individuale ekzistuese, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

- Kërkesë me shkrim të daktilografuar, ku të përcaktohen dhe kategoritë sipas zërave të punimeve të cilat individit kërkon të shtohen në licencën që disponon nga një aplikim i mëparshëm.

- Kopje të kartës së identitetit.
- Veprimtaria e tij e kryer nga aplikimi parardhës në formën e CV.

- Dokumentacion teknik justifikues (origjinal ose kopje të noterizuar) për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma, kopje projektsh (ose pjesë të tyre) ku personi ka qenë bashkautor, certifikata kursi apo specializimi që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet.

- Vetëdeklarim i individit mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e saj KTP (kushtet teknike të projektimit), dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit. (sipas formatit të lidhjes nr. 6/1)

- Në rastet kur personi kërkon të pajiset dhe me Licencë për mbikëqyrje e kolaudim punime zbatimi, personi duhet të përfshijë në vetëdeklarimin e mësipërm dhe pozicionin e tij në lidhje me punësimin në shoqëri ndërtimi (është apo nuk është i punësuar në ndonjë rol në këto shoqëri). (sipas formatit të lidhjes nr. 6/2)

- Kopje të licencës së mëparshme të individit.

- Dy fotografi për dokument të individit që kërkon të licencohet (fotografi të 3 muajve të fundit).

- Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr. 1).

Neni 28

Për pajisjen me dublikatë të licencës individuale

Aplikimi për pajisje me dublikatë të licencës individuale, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

- Kërkesë me shkrim të daktilografuar, ku të përcaktohen të dhënat e licencës që kërkon të dublohet, dhe arsyet e kërkesës për dublikatë.

- Vetëdeklarim i individit mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet, si dhe gjendjen në lidhje me penalizime nga strukturat shtetërore të inspektimit ndërtimor e urbanistik. (sipas formatit të lidhjes nr. 6/3).

- Kopje të licencës së mëparshme të individit.

- Në rastet kur personi kërkon të pajiset dhe me dublikatë të licencës për mbikëqyrje e



kolaudim punime zbatimi, personi duhet të përfshijë në vetëdeklarimin e mësipërm dhe pozicionin e tij në lidhje me punësimin në shoqëri ndërtimi (është apo nuk është i punësuar në ndonjë rol në këto shoqëri). (sipas formatit të lidhjes nr. 6/4).

- Dy fotografi për dokument të individit që kërkon të licencohet (fotografi të 3 muajve të fundit).

- Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr. 1).

Neni 29

Për rinovimin e kategorive të licencës individuale së mbikëqyrjes e kolaudimit

Aplikimi për rinovimin e formularit të përfutur përpara muajit shtator 2011, të licencës së mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, pasi të plotësohen kushtet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

- Kërkesë me shkrim të daktilografuar të individit, ku të përcaktohet të paktën; gjeneralitetet dhe të dhënat e licencës së disponuar më parë;

- Kopje të kartës së identitetit;

- Veprimtaria e tij e kryer nga aplikimi paraardhës në formën e CV-së.

- Dokumentacion teknik justifikues (origjinal ose kopje të noterizuar) për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma, certifikata kursi apo specializimi që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet.

- Vetëdeklarim i individit mbi:

- gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet;

- gjendjen në lidhje me penalizime nga strukturat shtetërore të inspektimit ndërtimor e urbanistik;

- pozicionin e tij në lidhje me punësimin në shoqëri ndërtimi (është apo nuk është i punësuar në ndonjë rol në këto shoqëri). (sipas formatit të lidhjes nr. 6/4);

- kopje të licencës së mëparshme të individit;

- dy fotografi për dokument të individit që kërkon të licencohet (fotografi të 3 muajve të fundit).

- dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr. 1).

Neni 30

Për ekuivalentimin e licencës profesionale për individë që disponojnë licencë profesionale në vendin e origjinës (jo Shqipëri)

Aplikimi për ekuivalentim të licencës profesionale individuale që individë kanë përfutur në vende të huaja, pasi të plotësohen kushtet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

- Kërkesë me shkrim të daktilografuar, ku të përcaktohen të paktën gjeneralitetet, adresën e plotë të individit dhe kategoritë sipas zërave të punimeve me të cilat individit kërkon të licencohet dhe ato që ai mendon se ekuivalenteohen nga licenca që disponon nga vendi i origjinës;

- Kopje të dokumentit të identitetit që disponon;

- Kopje të diplomës që disponon në vendin e origjinës, të njehsuar sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të autorizuar;

- Kopje të licencës (ose dokumentit që shërben si leje për ushtrimin e aktivitetit profesional respektiv) që disponon në vendin e origjinës, të njehsuar sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të autorizuar;

- Veprimtaria e tij e kryer nga marrja e diplomës në formën e CV-së.

- Dokumentacion teknik justifikues (origjinal ose kopje të noterizuar) për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma, kopje projektesh (ose pjesë të tyre) ku personi ka qenë bashkautor, certifikata kursi apo specializimi që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet;

- Vetëdeklarim i individit mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e saj KTP (kushtet teknike të projektimit) dhe të



gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit të lidhjes nr. 6/1);

- Në rastet kur personi kërkon të pajiset dhe me licencë për mbikëqyrje e kolaudim punime zbatimi, personi duhet të përfshijë në vetëdeklarimin e mësipërm dhe pozicionin e tij në lidhje me punësimin në shoqëri ndërtimi (është apo nuk është i punësuar në ndonjë rol në këto shoqëri) (sipas formatit të lidhjes nr. 6/2);

- Dy fotografi për dokument të individit që kërkon të licencohet (fotografi të 3 muajve të fundit);

- Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr. 1).

Neni 31

Për pajisje me licencë shoqërie për herë të parë

Aplikimi për pajisje me licencë shoqërie për herë të parë, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

- Kërkesë me shkrim të daktilografuar të drejtuesit ligjor të shoqërisë, ku të përcaktohet të paktën; emërtimi, rezidenca, adresa e plotë, drejtuesit ligjor e teknik të shoqërisë;

- Original ose kopje të noterizuar të ekstraktit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (dokument i lëshuar nga QKR-ja jo më parë se 1 muaj nga aplikimi);

- Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve ligjorë mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e saj KTP (kushtet teknike të projektimit) dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit të lidhjes nr. 6/1)

- Kontrata midis drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit).

- Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve teknikë:

- mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë për të cilën është kontraktuar;

- për gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në shoqëri të tjera që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit;

- për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore apo të pavarura dhe persona të tjerë, aktiviteti i të cilëve, bie ndesh me dispozitat ligjore apo nënligjore për nëpunësin civil (sipas formatit të lidhjes nr. 6/5).

- Kopje të licencës së drejtuesit apo drejtuesve teknik të shoqërisë.

- Në rastin kur mesatarja e notave të shkollës së lartë për individin që kërkon të regjistrohet drejtues teknik rezulton 9 ose më shumë, dhe ai ka vetëm 3 vite eksperiencë, paraqitet dhe lista e notave, kopje e njehsuar.

- Vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen nga shoqëria, të të gjitha detyrimeve tatimore.

- Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr. 1).

Për rastet kur kërkohet njëkohësisht dhe licencimi individual i drejtuesit/drejtuesve teknikë, aplikimi dhe kërkesat, në dëshirë të aplikuesve, hartohen dhe dërgohen bashkërisht pa mbivendosur apo dubluar dokumentet e kërkuara për të dyja aplikimet, sipas kësaj rregulloreje.

Neni 32

Për pajisje me shtesa në kategoritë e licencës së shoqërisë

Aplikimi për pajisje me shtesa të kategorive në licencën ekzistuese të shoqërisë (pa kërkuar ndryshime apo shtesa në drejtuesit teknik të shoqërisë), pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

- Kërkesë me shkrim të daktilografuar të drejtuesit ligjor të shoqërisë, ku të përcaktohet të paktën; kategoritë që kërkohet të shtohen.

- Kontratat midis drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, të hartuara përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit), për rastet kur kontratatave të depozituara më parë u ka kaluar afati i vlefshmërisë.

- Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve ligjorë mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e saj KTP (kushtet teknike të projektimit), dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit të lidhjes nr. 6/1).



- Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve teknikë:
 - mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë për të cilën është kontraktuar;
 - për gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në shoqëri të tjera që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit;
 - për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore apo të pavarura dhe persona të tjerë, aktiviteti i të cilëve, bie ndesh me dispozitat ligjore apo nënligjore për nëpunësin civil (sipas formatit të lidhjes nr. 6/5).
 - Kopje të licencës së shoqërisë dhe drejtuesit apo drejtuesve teknikë të saj.
 - Në rastin kur mesatarja e notave të shkollës së lartë për individin që kërkon të regjistrohet drejtues teknik rezulton 9 ose më shumë, dhe ai ka vetëm 3 vite eksperiencë, paraqitet dhe lista e notave, kopje e njehsuar.
 - Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr. 1)
 - Drejtuesi teknik plotëson dokumentacionin për shtesa në licencën e tij individuale (të cilat kalojnë automatikisht shoqërisë) sipas kërkesave të nenit 27 të kësaj rregullore, përjashtuar vetëdeklarimin i cili duhet të hartohet sipas kërkesës së këtij neni.

Neni 33

Për zgjatjen e afatit të licencës së shoqërisë apo dublikatë

- Aplikimi për zgjatjen e afatit të licencës ekzistuese të shoqërisë (pa kërkuar ndryshime apo shtesa në drejtuesit teknik të shoqërisë), pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:
- Kërkesë me shkrim të daktilografuar të drejtuesit ligjor të shoqërisë që kërkon zgjatje të afatit të licencës. Për rastet kur kërkohet dublikatë, të përcaktohen të dhënat e licencës që kërkon të dublohet dhe arsyet e kërkesës për dublikatë.
 - Kontratat midis drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, të hartuara përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit), për rastet kur kontratatave të depozituara më parë u ka kaluar afati i vlefshmërisë.

- Vetëdeklarim i drejtuesve ligjor në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të rilicencohet, si dhe gjendjen në lidhje me penalizime nga strukturat shtetërore të inspektimit ndërtimor e urbanistik (sipas formatit të lidhjes nr. 6/3).

- Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve teknikë:

- mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë për të cilën është kontraktuar;
- për gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në shoqëri të tjera që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit;
- për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore apo të pavarura dhe persona të tjerë, aktiviteti i të cilëve, bie ndesh me dispozitat ligjore apo nënligjore për nëpunësin civil (sipas formatit të lidhjes nr. 6/5).
- Kopje të licencës së shoqërisë dhe drejtuesit apo drejtuesve teknikë të saj.
- Vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen nga shoqëria, të të gjitha detyrimeve tatimore.
- Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr. 1).

Neni 34

Për rinovimin e kategorive të licencës së shoqërisë për mbikëqyrje e kolaudim

Aplikimi për rinovimin e formularit të përfutur përpara muajit shtator 2011, të licencës së mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

- Kërkesë me shkrim të daktilografuar e drejtuesit ligjor të shoqërisë, ku të përcaktohet të paktën të dhënat e licencës së disponuar më parë;
- Origjinal ose kopje të noterizuar të ekstraktit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për rastin kur nuk ka depozituar më parë një të tillë (dokument i lëshuar nga QKR-ja jo më parë se 1 muaj nga aplikimi);
- Veprimtaria e shoqërisë e kryer nga aplikimi paraardhës, në formën e CV-së.



- Dokumentacion teknik justifikues (original ose kopje të noterizuar) për çka është përshkruar si veprimtari e kryer nga shoqëria në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet.

- Vetëdeklarim i drejtuesve ligjorë në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të rilencohet, si dhe gjendjen në lidhje me penalizime nga strukturat shtetërore të inspektimit ndërtimor e urbanistik (sipas formatit të lidhjes nr. 6/3).

- Kontratat midis drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, të hartuara përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit), për rastet kur kontratatave të depozituara më parë u ka kaluar afati i vlefshmërisë.

- Kopje të licencës së shoqërisë dhe drejtuesit apo drejtuesve teknikë të saj.

- Vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen nga shoqëria, të të gjitha detyrimeve tatimore.

- Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr. 1).

Neni 35

Për ndryshim ose shtesë të drejtuesit ligjor

Aplikimi për ndryshimin e drejtuesit ligjor apo shtesë të tij, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

- Kërkesë me shkrim të daktilografuar e drejtuesit ligjor të ri të shoqërisë, ku të përcaktohet të paktën të dhënat e licencës së disponuar më parë;

- Original ose kopje të noterizuar të ekstraktit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në të cilin përcaktohet ndryshimi respektiv (dokument i lëshuar nga QKR-ja jo më parë se 1 muaj nga aplikimi).

- Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve ligjorë të rinj, në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të rilencohet (sipas formatit të lidhjes nr. 6/1);

- Kopje të licencës së shoqërisë;

- Vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen nga shoqëria, të të gjitha detyrimeve tatimore;

- Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr. 1).

Neni 36

Për ndryshim ose shtesë të drejtuesit/drejtuesve teknikë

Aplikimi për ndryshim ose shtesë të drejtuesit teknik, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

- Kërkesë me shkrim të daktilografuar e drejtuesit ligjor të shoqërisë, ku të përcaktohet të paktën të dhënat e licencës së disponuar më parë dhe drejtuesit teknik që do të largohen dhe ata që do të shtohen.

- Kopje të licencës së shoqërisë dhe drejtuesit apo drejtuesve teknikë që shtohen në shoqëri.

- Vetëdeklarim i drejtuesve ligjorë për gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës në lidhje me fushën ku është licencuar dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e saj KTP (kushtet teknike të projektimit) dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit të lidhjes nr. 6/1).

- Kontratat midis drejtuesit ligjorë dhe drejtuesit teknik të ri, të hartuara përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit).

- Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve teknikë:

- mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë për të cilën është kontraktuar;

- për gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në shoqëri të tjera që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit;

- për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore apo të pavarura dhe persona të tjerë, aktiviteti i të cilëve, bie ndesh me dispozitat ligjore apo nënligjore për nëpunësin civil (sipas formatit të lidhjes nr. 6/5).

- Në rastin kur mesatarja e notave të shkollës së lartë për individin që kërkon të regjistrohet drejtues teknik rezulton 9 ose më shumë, dhe ai ka vetëm 3 vite eksperiencë, paraqitet dhe lista e notave, kopje e njehsuar.



- Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr. 1).

Për rastet kur kërkohet njëkohësisht dhe licencimi individual i drejtuesit/drejtuesve teknikë që shtohen në shoqëri, aplikimi dhe kërkesat, në dëshirë të aplikuesve, hartohen dhe dërgohen bashkërisht pa mbivendosur apo dubluar dokumentet e kërkuara për të dy aplikimet, sipas kësaj rregulloreje.

Neni 37

Për ndryshim emërtim shoqërie

Aplikimi për ndryshim të emërtimit të shoqërisë, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

- Origjinal ose kopje të noterizuar të ekstraktit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në të cilin përcaktohet ndryshimi respektiv (dokument i lëshuar nga QKR-ja jo më parë se 1 muaj nga aplikimi);

- Vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen nga shoqëria, të të gjitha detyrimeve tatimore.

Neni 38

Për ekuivalentimin e licencës së shoqërive të huaja që disponojnë licencë profesionale në vendin e origjinës

Aplikimi për ekuivalentim të licencës profesionale që shoqëritë kanë përfutur në vende të huaja, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

- Kërkesë me shkrim të daktilografuar, ku të përcaktohen të paktën të dhënat e shoqërisë në lidhje me emërtimin, drejtuesit ligjor e teknik të saj, rezidencën, adresën e plotë dhe kategoritë sipas zërave të punimeve me të cilat shoqëria kërkon të licencohet dhe ato që mendon se ekuivalentohen nga licenca që disponon nga vendi i origjinës.

- Origjinal ose kopje të noterizuar të ekstraktit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, ku të përcaktohet lidhja e shoqërisë së krijuar e që kërkon të licencohet me atë të vendit të origjinës që disponon licencë profesionale (dokument i lëshuar nga QKR-ja jo më parë se 1 muaj nga aplikimi).

- Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve ligjor mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin që të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e saj KTP (kushtet teknike të projektimit) dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit të lidhjes nr. 6/1).

- Kontrata midis drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, të përkthyer e të noterizuara, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit).

- Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve teknikë:

- mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë për të cilën është kontraktuar;

- për gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në shoqëri të tjera që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit;

- për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore apo të pavarura dhe persona të tjerë, aktiviteti i të cilëve, bie ndesh me dispozitat ligjore apo nënligjore për nëpunësin civil (sipas formatit të lidhjes nr. 6/5).

- Kopje të licencës (ose dokumentit që shërben si leje për ushtrimin e aktivitetit profesional respektiv) që disponon shoqëria dhe drejtuesit teknik të shoqërisë në vendin e origjinës, të njehsuar sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të autorizuar.

- Kopje të diplomës që disponon drejtuesi/drejtuesit teknik të shoqërisë në vendin e origjinës, të njehsuar sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të autorizuar.

- Veprimtaria e kryer nga shoqëria nga marrja e licencës në vendin e origjinës, në formën e një CV.

- Dokumentacion teknik justifikues (origjinal ose kopje të noterizuar) për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma, kopje projektesh (ose pjesë të tyre), certifikata vlerësimi apo specializimi që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet.



- Vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen nga shoqëria, të të gjitha detyrimeve tatimore.

- Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisje me licencë profesionale (sipas lidhjes nr. 1).

Për rastet kur kërkohet njëkohësisht dhe licencimi individual i drejtuesit/drejtuesve teknikë që shtohen në shoqëri, aplikimi dhe kërkesat, në dëshirë të aplikuesve, hartohen dhe dërgohen bashkërisht pa mbivendosur apo dubluar dokumentet e kërkuara për të dy aplikimet, sipas kësaj rregulloreje.

Neni 39

Mbyllja e aktivitetit të shoqërisë

Aplikimi për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë në lidhje me studimin e projektimin apo/edhe mbikëqyrjen e kolaudimin, shoqërohet me:

- Njoftim me shkrim, nga drejtuesi ligjor, për mbylljen e aktivitetit;

- Dorëzimin e licencës/licencave që disponon.

Neni 40

Regjistrimi licencave profesionale

1. Të dhënat e licencave profesionale që miratohen nga Komisioni, regjistrohen në regjistrat themeltarë të licencave profesionale individuale dhe të shoqërive.

2. Regjistrat janë dokumente elektronike, në përgjegjësi të Sekretariatit teknik, ku regjistrohen të dhënat e licencimit të subjekteve, sa herë ato trajtohen dhe u miratohet licencim, dhe të paktën parametrat:

- emërtimi i subjektit të licencuar;
- numri dhe data e vendimit në të cilin është miratuar licenca e subjektit;
- numri i licencës;
- kategoritë e miratuara;
- afati i vlefshmërisë.

3. Të dhënat përditësohen në përputhje me ndryshimet që licencat pësojnë si rezultat i aplikimeve, miratimeve apo penalteteve.

4. Regjistrat janë dokumente publike të cilat në përgjegjësi të Sekretariatit teknik, publikohen në faqen zyrtare të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe u mundësohet aksesimi në to çdo enti publik apo privat.

KREU VI SANKSIONE DHE DISPOZITA KALIMITARE

Neni 41

Masa disiplinore ndaj subjekteve të licencuara

1. Heqja e të drejtës për ushtrimin e aktivitetit apo pezullim të përkohshëm të aktivitetit profesional në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim, për periudha të ndryshme, si për individë apo shoqëri, bëhet nga Komisioni, në këto raste kur:

a) konstatohen deklarime (sipas parashikimeve në këtë rregullore) të rreme apo dokumente të pavërteta;

b) ka falsifikime të evidencave e formularëve që kërkohen nga Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit në zbatim të kësaj rregullore;

c) kryen veprimtari pa drejtues teknik/nuk plotëson detyrimet që rrjedhin nga kjo rregullore;

d) drejtuesi teknik largohet pa arsye nga shoqëria;

e) ka propozime të motivuara nga institucione shtetërore, për shkelje të ligjshmërisë në ndërtim.

Për çdo rast, nga Sekretariati teknik ose grup ekspertësh, hartohet raport vlerësimi dhe shqyrtohet në mbledhjen e radhës të Komisionit.

2. Masa për shoqëritë, drejtuesit teknikë dhe individët e licencuar, sipas shkeljeve të bëra gjatë ushtrimit të veprimtarisë janë me heqje të së drejtës të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, për: 6 muaj, 1 vit, 2 vjet, 3 vjet ose përgjithmonë; tërësisht ose pjesërisht për klasat dhe kategoritë e që disponon në licencë.

3. Për masat e vendosura nga Komisioni, njoftohet brenda një dite subjekti ndaj të cilit është vendosur masa dhe struktura e inspektoratit ndërtimore e urbanistik kombëtar dhe për rastet e deklarimeve të rreme, sanksionet ligjore për licencimin shoqërohen dhe me kallëzim në organet kompetente.

Neni 42

Ankimi

1. Për çdo vendim të Komisionit, individët apo përfaqësuesit e shoqërive, kanë të drejtën e ankimit tek Ministri Zhvillimit Urban dhe Turizmit, brenda 10 ditëve, nga data e njoftimit apo publikimit.



2. Titullari i Ministrisë pasi merr në shqyrtim ankesën e paraqitur nga subjekti vendos, brenda 10 ditëve:- lënien në fuqi të vendimit të marrë nga Komisioni;

- kthen për rishqyrtim vendimin e marrë në Komision;

- anulon vendimin e marrë.

Neni 43

Dispozita kalimtare

1. Verifikimi i deklarimeve të subjekteve aplikuese kryhet në bazë të informacioneve që disponohen nga ente publike apo private, ose me përzgjedhje nga Sekretariati teknik pranë institucioneve kompetente, brenda 30 ditëve nga hartimi i materialit përkatës për Komisionin e Posaçëm.

2. Procedurat dhe afatet e verifikimit nuk pengojnë procesin e licencimit të subjekteve. Në

rastet e konstatimit të deklarime të rreme zbatohen masat e përcaktuara në nenin 41 të kësaj rregullore.

3. Të gjithë formularët e licencave profesionale individuale për studim e projektim që individët disponojnë nga miratimet e Komisioneve të mëparshme, të cilat nuk kanë të përcaktuar afat vlefshmërie, mbeten të vlefshme.

4. Individët dhe shoqëritë që disponojnë licenca profesionale për ushtrim aktiviteti në fushën e mbikëqyrje e kolaudimit sipas kategorive të specifikuara në këtë rregullore, në të cilat nuk përcaktohet afat vlefshmërie, mbeten të vlefshme. Ndërsa licencat e mbikëqyrjes e kolaudimit me kategori jo sipas kategorive të miratuara me këtë rregullore janë të pavlefshme dhe duhet të paraqiten për rinovimin e tyre sipas përcaktimeve në këtë rregullore. Pjesë e kësaj rregullore janë lidhjet bashkëngjitur

ANEKS

Lidhja 1	Tarifat e pagesës për marrjen e licencës profesionale
Lidhja 2	Kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim
Lidhja 3	Kategoritë në fushat e mbikëqyrje dhe kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim
Lidhja 4	Kushte dhe kriteret specifike për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit
Lidhja 5	Kushte dhe kriteret specifike për të fituar kategoritë në fushat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit
Lidhja 6	Vetëdeklarimet

LIDHJA 1 TARIFA

Për personat fizikë e juridikë vendas dhe të huaj që pajisen me licencë profesionale zbatohen këto tarifa:

Licencim individual për herë të parë	1 (një) euro
Shtesa në kategoritë e licencës individuale	1 (një) euro
Rinovim ose dublikatë të licencës individuale	1 (një) euro
Licencim të shoqërisë për herë të parë	1 (një) euro
Shtesa në kategoritë e licencës së shoqërisë	1 (një) euro

Ndryshim të drejtuesit/drejtuesve ligjorë apo teknikë	1 (një) euro
Zgjatje të afatit/rinovim/dublikatë të licencës së shoqërisë	1 (një) euro

LIDHJA 2 KATEGORITË NË FUSHAT E STUDIMIT DHE PROJEKTIMIT NË NDËRTIM

1. PROJEKTUES URBANIST

- Masterplane - studime e plane rajonale urbanistike.
- Plane rregulluese të përgjithshme për qendra të banuara dhe qytete.
- Studime pjesore urbanistike.



2. PROJEKTUES ARKITEKT

- Projektim arkitektonik për objekte civile - industriale-turistike-vepra arti në infrastrukturë.
- Projektim arkitektonik për objekte sportive.
- Projektim interiere.
- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

- Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

1. Objekte civile - industriale - turistike mbi 5 kate – 2. objekte me skelet metalik.

1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme – metalike – 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.

4. PROJEKTUES INSTALATOR

- Instalime hidrosanitare.
- Instalime termoteknik-ventilimi-kondicionimi.
- Linja e rrjeta elektrike-telefonike-radiotelefoni-citofoni-sistem alarmi-televiziv etj. për objekte civile, industriale, turistike.
- Sisteme komplekse të telekomunikacionit.
- Sisteme të furnizimit me gaz.

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

- Diga – galeri – tunele hidraulike.
- Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.
- Ujësjiellës-kanalizime urbane - rurale.
- Vepra ujitje – kullimi – impiante vaditëse – diga deri 10m - damba.
- Vepra të trajtimit të ujit.
- Vepra hidroteknike, marrje uji, shkarkimi-kulla ekuilibri-porte- pontile,

- Vepra naftësjellës – gazsjellës – vajsjiellës etj.

6. PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA

- Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
- Projektim rruge urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.
- Shtresa rrugore e sistemim - asfaltim.
- Autostrada – aeroporte – heliporte.
- Hekurudha – degëzime hekurudhore.

7. PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI

- Ura dhe vepra arti të vogla deri me 10 m.
- Ura dhe vepra arti mbi 10 m - Estakada.
- Ura metalike.
- Tunele rrugore - hekurudhore.

8. PROJEKTUES GJEODET

- Bazamente gjeodezike – rivlime në të gjitha shkallët.
- Projektim fotogrametrik – hartografik - topografik.

9. STUDIM GJEOLIGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLJIK

- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për

objekte civile – ekonomike deri 5 kate.

- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike mbi 5 kate.

- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte të mëdha H/C, porte aeroporte, bazamente me

- ngarkesa të mëdha.

- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

Studime e projekte hidrogeologjike.

10. PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË

- Centrale hidraulike (elektrik, primare, sekondare).

- Centrale termike (primare, sekondare).

- Impiante të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike – diellore – era etj.

- Nënstacione elektrike, primar sekondar – linja të tensionit të lartë.

- Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.

11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR

- Sinjalistikë në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

- Sinjalistikë në autostrada, rruge urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën.

- Në aeroporte dhe heliporte.

12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE (vetëm për shoqëri/subjekte juridike).

- Studime/vlerësim të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.

- Studime/vlerësim gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.

- Studime/vlerësim të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.

- Studime/vlerësim të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte komplekse, si: hidrocentrale (për çdo fuqi të instaluar), termocentrale, porte, aeroporte, tunele për vepra hidroteknike, bazamente për ngarkesa të mëdha dhe objekte industriale.

- Studime/vlerësim të sizmologjisë inxhinierike për troje e shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkrifta me mundësi lëngëzimi.

- Studime të rrezikut sizmik në nivel rajonal (mikrozona sizmike) dhe në nivel kombëtar (hartat kombëtare të rrezikut sizmik).

13. STUDIME E PROJEKTIME TË NDËRTIMIT DHE MBYLLJES SË VENDDEPOZITIMEVE TË MBETJEVE TË NGURTA (URBANE) (vetëm për shoqëri/ subjekte juridike).



LIDHJA 3
KATEGORITË NË FUSHAT E
MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIMIT TË
PUNIMEVE TË ZBATIMIT NË NDËRTIM

I. PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- NP-1 Punime gjurmimi në tokë.
 NP-2 Ndërtime civile dhe industriale.
 NP-3 Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
 NP-4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tranvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.
 NP-5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti.
 NP-6 Diga dhe tunele hidroteknike.
 NP-7 Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.
 NP-8 Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë.
 NP-9 Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime.
 NP-10 Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike.
 NP-11 Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
 NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- II. PUNIME SPECIALE NDËRTIMI**
- NS-1 Punime për prishjen e ndërtimeve.
 NS-2 Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
 NS-3 Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).
 NS-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
 NS-5 Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.
 NS-6 Sinjalistika rrugore jondriçuese.
 NS-7 Barrierra dhe mbrojtje rrugore.
 NS-8 Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
 NS-9 Punime strukturorë speciale.
 NS-10 Shtresa dhe mbistruktura speciale.
 NS-11 Punime mbi shina dhe traversa.
 NS-12 Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
 NS-13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.
 NS-14 Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
 NS-15 Pastrimi i ujërave detare, liqenore dhe lumore.
 NS-16 Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij.

NS-17 Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane.

NS-18 Punime topogjeodezike.

NS-19 Sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë

NS-20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

LIDHJA 4
KUSHTE DHE KRITERE SPECIFIKE PËR
TË FITUAR KATEGORITË NË FUSHAT E
STUDIMIT DHE PROJEKTIMIT

1. PROJEKTUES URBANIST

1. Profili i diplomimit sipas kategorive të projektimit:

- a) Profili urbanist/planifikim territorial.
- b) Profili urbanist/planifikim territorial.
- c) Profili urbanist/planifikim territorial/të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Profili Ndërtime Qytetare Industriale para vitit 1971/ Profili Arkitekturë.

2. Vite eksperiencë, në institucionet publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë, sipas kategorive:

- a) Mbi 10 vjet
- b) Mbi 5 vjet
- c) Mbi 2 vjet

2. PROJEKTUES ARKITEKT

1. Profili për kategorinë “a” projektimit

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili ndërtime qytetare industriale para vitit 1971.

- Profili arkitekturë / profili urbanist.

2. Profili për kategoritë “b” dhe “c” projektimit.

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili ndërtime qytetare Industriale para vitit 1971.

- Profili arkitekturë.

3. Profili për kategorinë “d” projektimit

- Profili arkitekturë/profili urbanist/të ketë mbaruar Universitetin Bujqësor profili Shkencat pyjore.

4. Vite eksperiencë në institucionet publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë:

- a) Mbi 5 vjet
- b) Mbi 7 vjet
- c) Mbi 2 vjet
- d) Mbi 2 vjet

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

1. Profili për kategoritë nga “a” në “c” të projektimit Inxhinier në profilet e ndërtimit.

3. Vite eksperiencë në institucionet publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë:

- a) Mbi 3 vjet
- b) Mbi 5 vjet



c) Mbi 10 vjet

4. PROJEKTUES INSTILATOR

1. Sipas kategorive të projektimit:

a) Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili Inxhinier Ndërtimi Qytetare Industriale deri në vitin 1971/Inxhinier hidroteknik.

b) Profili inxhinier mekanik termoteknik.

c) Profili inxhinier elektrik/elektronik.

d) Profili inxhinier elektrik/elektronik.

e) Profili inxhinier mekanik për impiante.

2. Vite eksperiencë në institucionet publike projektuese, studio private projektimi ose Universiteti Politeknik

a) Mbi 5 vjet

b) Mbi 7 vjet

c) Mbi 7 vjet

d) Mbi 10 vjet

e) Mbi 7 vjet

5. PROJEKTUES VEPRRA HIDRAULIKE

1. Për kategoritë “a” deri në “f” të projektimit:

- Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi qytetare industriale deri në vitin 1971 / profili hidroteknik.

2. Për kategorinë “e” të projektimit edhe:

- Profili mjedis ujëra.

2. Për kategorinë “g” të projektimit:

Të ketë mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë, profili inxhinier ndërtimi deri në vitin 1971 / inxhinier hidroteknik / inxhinier mekanik profili impiante.

3. Vite eksperiencë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë:

a) Mbi 15 vjet

b) Mbi 7 vjet

c) Mbi 5 vjet

d) Mbi 7 vjet

e) Mbi 10 vjet

f) Mbi 15 vjet

g) Mbi 10 vjet

6. PROJEKTUES RRUGË - HEKURUDHA

1. Për kategoritë nga “a” deri në “c” të projektimit:

- Inxhinier në profilet e ndërtimit.

2. Për kategorinë “d” dhe „e” të projektimit:

- Inxhinier ndërtimi për ndërtime rrugore, për infrastrukturë transporti.

3. Vite eksperiencë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë:

h) Mbi 3 vjet

i) Mbi 10 vjet

j) Mbi 7 vjet

k) Mbi 10 vjet

l) Mbi 10 vjet

7. PROJEKTUES URA DHE VEPRRA ARTI

1. Për kategoritë nga “a” deri në “d” të projektimit:

- Inxhinier në profilet e ndërtimit.

2. Vite eksperiencë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë:

a) Mbi 5 vjet

b) Mbi 10 vjet

c) Mbi 10 vjet

d) Mbi 15 vjet

8. PROJEKTUES GJEODET

1. Për kategoritë “a” dhe “b” të projektimit:

a) Profili Inxhinier gjeodet/inxhinier topograf/Profili markshajder.

2. Vite eksperiencë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë.

a) Mbi 7 vjet.

b) Mbi 10 vjet

9. STUDIUES-PROJEKTUES GJEOLIGO INXHINIERIK

1. Për kategoritë nga “a” në “d” të projektimit:

- Profili Gjeolog.

2. Për kategorinë “e” të projektimit:

- Profili Inxhinier hidrogeolog.

3. Vite eksperiencë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë:

a) Mbi 5 vjet

b) Mbi 7 vjet

c) Mbi 10 vjet

d) Mbi 15 vjet

e) Mbi 10 vjet

10. PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË

1. Për të gjitha kategoritë:

a) Profili Inxhinier elektrik.

2. Për kategorinë “c” të projektimit edhe:

a) Profili Inxhinier Mjedis energjetik.

3. Vite eksperiencë në institucione publike projektuese, studio private projektimi ose institucione të arsimit të lartë:

a) Mbi 15 vjet.

b) Mbi 10 vjet

c) Mbi 7 vjet.

d) Mbi 5 vjet.

11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR

1. Për kategoritë nga “a” deri në “c” të projektimit:

a) Profili Inxhinier për ndërtime rrugore dhe për infrastrukturën në transport / inxhinier mekanik transporti.

2. Vite eksperiencë në subjekte publike dhe jopublike projektuese, në institucione të arsimit të lartë:

a) Mbi 3 vjet.

b) Mbi 5 vjet.



c) Mbi 7 vjet.

12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE (vetëm për shoqëri/subjekte juridike).

Këtë grup kategorie e përfitojnë shoqëritë/subjektet juridike që kanë të regjistruar për drejtues teknik një apo më shumë specialistë të lartë të cilët:

1. Duhet të kenë jo më pak se 5 (pesë) vjet eksperiencë profesionale në studime të sizmiologjisë inxhinierike, dhe të plotësojnë të paktën njërin nga kriteret në vijim.

2. Diplomë profili gjeofizikë dhe të plotësojnë të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

- të kenë kryer specializime jashtë shtetit (jo më pak se gjashtë muaj) për sizmiologjinë inxhinierike.

- të kenë qenë punonjës shkencor në Institutin e Sizmiologjisë dhe të kenë marrë pjesë në kryerjen e studimeve të sizmiologjisë inxhinierike për rrezikun sizmik në nivel kombëtar dhe lokal.

- të jenë titullar lënde për fusha të sizmiologjisë inxhinierike.

3. Duhet të kenë kryer programe universitare të nivelit master ose doktoraturë në sizmiologji inxhinierike.

4. Vite eksperiencë në institucione projektuese publike, studio private ose institucione të arsimit të lartë sipas kategorive duhet të jetë:

- mbi 5 vjet për pikën 12a.

- mbi 8 vjet për pikat 12bcd.

- mbi 10 vjet për pikat 12ef.

13. STUDIME E PROJEKTIME TË NDËRTIMIT DHE MBYLLJES SË VENDEPOZITIMEVE TË MBETJEVE TË NGURTA (URBANE) (vetëm për shoqëri/ subjekte juridike).

Këtë kategori e përfitojnë shoqëritë/subjektet juridike që kanë të regjistruar për drejtues teknik të paktën dy specialist të lartë të cilët:

- duhet të kenë jo më pak se 5 (pesë) vjet eksperiencë profesionale në këtë fushë;

- një specialist duhet të ketë diplomë në profilin Mjedisë ose Kimi teknologjike (për këtë të fundit të jenë diplomuar përpara vitit 1985);

- një specialist duhet të ketë diplomë Inxhinieri në profilet e Ndërtimit ose Hidroteknik.

LIDHJA 5

KUSHTE DHE KRITERE SPECIFIKE PËR TË FITUAR KATEGORITË NË FUSHAT E MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT NË NDËRTIM

I. PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

NP-1 Punime gërmimi në tokë.

- Inxhinier në profilet e Ndërtimit.

NP-2 Ndërtime civile dhe industriale.

- Inxhinier në profilet e Ndërtimit/Arkitekt të diplomuar përpara vitit 1985.

NP-3 Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

- Inxhinier në profilet e Ndërtimit/Arkitekt.

NP-4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.

- Inxhinier në profilet e Ndërtimit.

NP-5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti.

- Inxhinier në profilet e Ndërtimit.

NP-6 Diga dhe tunele hidroteknike.

- Inxhinier Ndërtimi i diplomuar në degën Inxhinier për ndërtime qytetare industriale përpara vitit 1971/- Inxhinier profile Hidroteknik.

NP-7 Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje.

- Inxhinier në profilet e ndërtimit.

NP-8 Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë.

- Inxhinier në profilet e ndërtimit.

NP-9 Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.

- Inxhinier në profilet e ndërtimit.

NP-10 Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike.

- Inxhinier profili elektrik.

NP-11 Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

- Inxhinier profili elektrik.

NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit.

- Inxhinier profili mjedis / Universiteti Bujqësor dega e mjedisit.

II. PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS-1 Punime për prishjen e ndërtimeve.

- Inxhinier në profilet e ndërtimit.

NS-2 Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanderi, mirëmbajtja e tyre.

- Inxhinier në profilet e ndërtimit.

NS-3 Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)

- Inxhinier profili mekanik.

NS-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.

- Inxhinier në profilet e Ndërtimit / Arkitekt.

NS-5 Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.

- Inxhinier në profilet Elektrik /Elektronik.

NS-6 Sinjalistika rrugore jondriçuese.

- Inxhinier Ndërtimi i diplomuar në degën Inxhinier për ndërtime qytetare industriale përpara vitit 1971/ Inxhinier profili infrastrukturë e transportit.

NS-7 Barriera dhe mbrojtje rrugore.

- Inxhinier në profilet e ndërtimit.

NS-8 Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.



- Inxhinier në profilet e ndërtimit.
- NS-9 Punime strukturorë speciale.
- Inxhinier në profilet e ndërtimit.
- NS-10 Shtresa dhe mbistruktura speciale.
- Inxhinier në profilet e ndërtimit.
- NS-11. Punime mbi shina dhe traversa.
- Inxhinier ndërtimi i diplomuar në degën inxhinier për ndërtime qytetare industriale përpara vitit 1971/ inxhinier profili infrastrukturë e transportit.
- NS-12 Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
- Inxhinier mekanik profili termoteknike.
- NS-13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.
- Inxhinier profili elektrik/elektronik.
- NS-14 Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- Inxhinier profili elektrik/elektronik.
- NS-15 Pastrimi i ujërave detarë, liqenor dhe lumor.
- Inxhinier profili mjedis ujëra.
- NS-16 Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij.
- Inxhinier profili mjedis ujëra/inxhinier hidroteknik/kimist teknolog.
- NS-17 Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane.
- Inxhinier profili mjedis ujëra.
- NS-18 Punime topogjeodezike.
- Inxhinier profili gjeodet / topograf/markshaidër
- NS-19 Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë.
- Inxhinier profili mjedis profili energjetikë/ inxhinier ndërtimi profili infrastrukturë e transportit.
- NS-20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.
- Inxhinier profili gjeolog.

LIDHJA NR. 6 VETËDEKLARIMET

6/1.

“Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se: Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohem (ose në rast se ka – të deklarojë: Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit _____ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe jam në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit _____ (shoqëruar me motivin e ndjekjes)”.

“Deklaroj se njoh e do të zbatoj në veprimtarinë time si individ, kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit”.

6/2.

“Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se: Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohem (ose në rast se ka – të deklarojë: Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit _____ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe jam në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit _____ (shoqëruar me motivin e ndjekjes).

“Deklaroj se njoh e do të zbatoj në veprimtarinë time si individ, Kushtet Teknike të Projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit”

“Gjithashtu, deklaroj se nuk jam i punësuar në asnjë shoqëri që ushtron aktivitet në fushën e zbatimit në ndërtim”.

6/3.

“Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se: Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohem (ose në rast se ka – të deklarojë: Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit _____ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe jam në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit _____ (shoqëruar me motivin e ndjekjes).

“Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se: Nuk kam asnjë penalizim nga strukturat shtetërore të ngarkuara për inspektimin ndërtimor e urbanistik. (ose në rast se ka – të deklarojë: Kam penalizim nga struktura shtetërore qendrore ose vendore _____ (shoqëruar me motivin e penalizimit).

6/4.

“Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se: Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohem (ose në rast se ka – të deklarojë: Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit _____ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe jam në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit _____ (shoqëruar me motivin e ndjekjes).



“Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se: Nuk kam asnjë penalizim nga strukturat shtetërore të ngarkuara për inspektimin ndërtimor e urbanistik. (ose në rast se ka – të deklarojë: Kam penalizim nga struktura shtetërore qendrore ose vendore _____ (shoqëruar me motivin e penalizimit).

“ Gjithashtu, deklaroj se nuk jam i punësuar në asnjë shoqëri që ushtron aktivitet në fushën e zbatimit në ndërtim”.

6/5.

“Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se: Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohem (ose në rast se ka – të deklarojë: Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit _____ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe jam në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit _____ (shoqëruar me motivin e ndjekjes).

“Gjithashtu, deklaroj se nuk jam i punësuar në rolin e drejtuesit teknik në asnjë shoqëri që ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit”.

“ Gjithashtu, deklaroj se nuk jam në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore apo të pavarura dhe persona të tjerë, aktiviteti i të cilëve, bie ndesh me dispozitat ligjore apo nënligjore për nëpunësin civil”.

VENDIM

Nr. 801, datë 26.11.2014

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NGA/ NË DETYRË TË DISA ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 19/2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të neneve 116 e 117, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lirimimin nga detyra të anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, si më poshtë

Faqe|9342

vijon:

- Znj. Vilma Kruja Kadesha anëtar;
- Z. Denis Martopulla anëtar.

2. Emërimin në detyrë të anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, si më poshtë vijon:

- Znj. Juliana Hoxha anëtar;
- Z. Spiro Kuro anëtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

UDHËZIM

Nr. 20, datë 17.11.2014

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 30, DATË 27.12.2011 “PËR MENAXHIMIN E AKTIVEVE NË NJËSITË E SEKTORIT PUBLIK”

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 6, germa “e” të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 54 riformulohet: “Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja origjinale ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, certifikatë origjinale dhe cilësie, fletë analize laboratorike, garanci malli etj.”.

2. Në pikën 64 shtohet një paragraf si më poshtë:

“Përfashtim bëjnë vetëm arkëtimet e tarifave për shërbimin shëndetësor ofruar pacientëve nga njësitë shpenzuese të shërbimit shëndetësor.”.

3. Në pikën 73 fjalia e fundit ndryshohet me këtë përmbajtje “Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe me urdhër/ udhëzim të miratuar nga titullari i njësisë publike.”.



4. Pika 85/c riformulohet: “Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësim paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues”.

5. Në pikën 90/c togfjalëshi “ose vlerës së drejtë por jo më të vogël se vlera neto kontabël”, zëvendësohet me togfjalëshin “ose vlerës së drejtë por jo më pak se 50% të çmimit të blerjes ose të vlerës bruto”.

6. Pika 96 riformulohet: “Procesi i vlerësimit të aktiveve realizohet nga komisioni i vlerësimit, ndërsa procesi i dhënies në përdorim/tjetërsim apo nxjerrjes jashtë përdorimit kryhet nga komisioni i nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në njësi. Komisioni i vlerësimit ngrihet me miratim të titullarit. nëpunësi autorizues ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit.

Për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të organizuara me disa nivele vartësie të njëjshme shpenzuese, komisioni i vlerësimit ngrihet nga nëpunësi autorizues i nivelit të dytë në vartësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë publike.

Nëpunësi autorizues i nivelit të dytë ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit në njësitë e vartësisë së tij, i cili raporton tek nëpunësi autorizues i njësisë publike”.

7. Pika 100 riformulohet: “Komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përbëhet nga jo më pak se 5 vetë, kryetari i këtij komisioni përcaktohet nga Titullari dhe anëtarë përcaktohen nga kryetari, në varësi të kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të dhëna në paragrafët 111 deri 118 të këtij udhëzimi.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

UDHËZIM

Nr. 21, datë 17.11.2014

MBI PROCEDURËN E PAGESAVE TË DETYRIMEVE E DOGANORE TË PAGUARA TEPËR NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të neneve 248 – 255, të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të neneve 13 – 15 të ligjit nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave procedon me kthimin e detyrimeve doganore të paguara tepër, duke paraqitur në degën përkatëse të thesarit urdhërpaguesën për rimbursim sipas modelit nr. 1 bashkëngjitur këtij udhëzimi, të detajuar sipas klasifikimit ekonomik të të ardhurave doganore, për të cilat bëhet kthimi i detyrimeve doganore të paguara tepër.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani



Emërtimi i Institucionit	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave						
NIPT - i	XXXXXXXXXX						
Kodi i Institucionit	1010XXXX						
Entiteti i Qeverisjes	001						
Rrethi	XXXX						
Nr. i Kuponit							
URDHËR - PAGESË RIMBURSIMI							
Nr.	Datë						
. .20							
Nr.	Struktura e llogarive_kodi						SHUMA
	Institucioni	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Nën Llogaria	Kod Projekti	në Lekë
1							
2							
3							
TOTALI ME SHIFRA							XXX,XXX.XX X
TOTALI ME FJALË							(.....)
IBAN: AL							
Të dhëna për kreditorin përfitues:							
Emri i përfituesit							
NIPT - i							
Nr.llog.bankare të subjektit							
Emri i Bankës							
Adresa e Bankës							
XXXXXX (p.sh.Tiranë)							
Dokumentat ngjitur Urdhër Pagesës Rimbursimit:							
Emërtimi	Nr. Dokumenti	Data e Dokumentit					
Njoftimi	nr. XXX	datë . .20					
Të tjera							
(Emërtime,							
numër,							
datë)							
PER INSTITUCIONIN							
URDHËRUESI I DOGANAVE							
NËNPUNËSI I DOGANAVE							
Vula							
PER DEGEN E THESARIT							
Aprovuar datë							
DREJTORI I DEGES SE THESARIT							
Vula							

Shënim: Qelizat për "Nr. i kuponit" dhe "Aprovuar datë", plotësohen nga nëpunesi i Degës së Thesarit
Formati i këtij Urdhër Pagesë Rimbursimi është miratuar nga Ministri i Financave me udhëzimin nr. datë . .20

UDHËZIM Nr. 22, datë 19.11.2014

PËR MBIKËQYRJEN E OJF-VE, NGA ORGANET TATIMORE, NË FUNKSION TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 dhe 118 të Kushtetutës, si dhe neni 41 të ligjit nr. 8788, datë 17.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim rregullon procedurat që ndiqen nga organet tatimore, si organ mbikëqyrës, për kontrollin e veprimtarisë së OJF-ve, me qëllim

shmangien e mundësisë së përdorimit të tyre për pastrim parash apo financim terrorizmi.

Neni 2 Përkufizime

Për qëllime të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

"Pastrim parash" është qarkullimi dhe riciklimi i parave, të cilat burojnë nga vepra penale sikurse dhe ndryshimi, transmetimi, transformimi dhe tjetërsimi i produkteve dhe i pasurive që burojnë nga vepra penale, që synojnë fshehjen e burimit të paligjshëm të origjinës, sipas kuptimit të dhënë në nenin 287 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

"Burim i financimit" konsiderohen të ardhurat e organizatës jofitimprurëse sipas përcaktimeve të nenit 35 të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", të ndryshuar.



“Financim i terrorizmit” ka të njëjtin kuptim si në nenin 230/a deri në 230/d të Kodit Penal.

“Njësi qendrore” ka të njëjtin kuptim si në udhëzimin nr. 16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”.

“Raportim rasti” është plotësimi dhe përcjellja e RAD-së, formularit në aneksin II bashkëlidhur udhëzimit nr. 16, datë 16.9.2009 të Ministrit të Financave “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”.

Neni 3

Regjistrimi dhe çregjistrimi i OJF-ve

Organizatat jofitimprurëse regjistrohen në administratën tatimore, pasi kanë kryer më parë regjistrimin në gjykatë, në përputhje me legjislacionin e fushës.

Regjistrimi i organizatave jofitimprurëse bëhet në drejtorinë rajonale tatimore të juridiksionit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Çregjistrimi i organizatave jofitimprurëse bëhet nga gjykata sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të udhëzimit nr. 24, datë 2.9.2008 “për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 4

Raportimi periodik për OJF-të

Organet tatimore të juridiksionit çdo gjashtë muaj evidentojnë dhe i raportojnë “Njësisë qendrore”, strukturë përgjegjëse në DPT, sipas përcaktimeve në udhëzimin nr. 16, datë 16.9.2009 të Ministrit të Financave “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, për OJF-të që zhvillojnë aktivitetet pa u regjistruar, OJF-të me status pasiv dhe OJF-të që nuk dorëzojnë deklaratat tatimore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Mbajtja dhe administrimi i dokumentacionit

Drejtoritë rajonale tatimore të juridiksionit administrojnë në dosjet e OJF-ve të regjistruara, të gjithë dokumentacionin e themelimit, të regjistrimit, të ndryshimeve pas regjistrimit si dhe dokumentacionin tatimor të parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi dhe Ligji nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar.

Dosjet e OJF-ve mbahen në një seksion të veçantë të arkivit së drejtorisë rajonale tatimore.

Neni 6

Kontrolli në terren i OJF-ve

Organet tatimore të juridiksionit, strukturat e kontrollit në terren, evidentojnë OJF-të që ushtrojnë aktivitet në territorin e tyre dhe kontrollojnë periodikisht regjistrimin në organin tatimor, përditësimin e të dhënave të regjistrimit, deklarimin e të punësuarve, si dhe zhvillimin e veprimtarisë ekonomike. Nëse kryhet veprimtari ekonomike nga OJF-të, ajo duhet të jetë në përputhje me nenin 4/1 dhe nenin 40 të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar.

Neni 7

Kontrolli i pasqyrave financiare të OJF-ve

1. Drejtoritë rajonale tatimore të juridiksionit ngarkojnë punonjësit të specializuar dhe të trajnuar për shqyrtimin e pasqyrave financiare të OJF-ve, në varësi të numrit të OJF-ve që administrojnë, të cilët analizojnë veçanërisht, por pa u kufizuar në:

- a) Burimet e financimit të OJF-së
- b) Veprimtarinë ekonomike të OJF-së, nëse zhvillon veprimtari ekonomike.
- c) Përdorimin e fondeve dhe mënyrën e qarkullimit të tyre.
- d) Asetet e OJF-së dhe burimin e krijimit të tyre.

2. Informojnë “Njësinë Qendrore” në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për OJF-të që nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare vjetore dhe gjithashtu për masat administrative të ndërmarra ndaj tyre.

3. Për rastet e financimeve që paraqesin risk bazuar në tipologjitë e shtojcës bashkëlidhur



udhëzimit nr. 16, datë 16.9.2009 të Ministrit të Financave “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, i kërkojnë strukturave përkatëse ushtrimin e kontrollit të themeluar operacional.

Neni 8

Kontrolli operacional i OJF-ve

Organet tatimore të juridiksionit, strukturat e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, ushtrojnë kontroll të thelluar operacional ndaj OJF-ve, sipas përcaktimit në pikën nr. 3, neni 7 të këtij udhëzimi. Gjatë kontrollit operacional duhet të mbahen parasysh sa më poshtë dhe jo vetëm:

1. Evidentimi i burimeve të financimit, marrëveshjet për grantet e përfituara, marrëveshjet për dhurimet dhe donacionet, dokumentimin e kuotave të anëtarësisë;

2. Verifikimi nëse OJF-ja realizon veprimtari ekonomike dhe nëse ka të ardhura nga kjo veprimtari;

3. Verifikimi i deklarimit pranë organit tatimor të numrit të llogarisë bankare ku i kalojnë donacionet;

4. Verifikimi i faktit nëse fondet e organizatave jofitimprurëse mbahen në llogari bankare dhe nëse transferimi apo transaksionet financiare në lidhje me këto fonde kryhen nëpërmjet sistemit bankar, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi;

5. Kryerja e detyrave nga organi më i lartë vendimmarrës, bordi i drejtorëve, apo mbledhja e përgjithshme e anëtarëve, sipas nenit 20 të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” në lidhje me:

a) Miratimin e pasqyrave financiare të paraqitura nga organi ekzekutiv;

b) Mbikëqyrjen e organizatës jofitimprurëse, me qëllim parandalimin e përdorimit të burimeve të organizatës për qëllime terroriste, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

c) Marrëveshjet për grantet, dhurimet dhe donacionet.

6. Verifikimi nëse fondet e grumbulluara janë përdorur për qëllimin e deklaruar.

7. Nëse organizatat jofitimprurëse, që ushtrojnë veprimtari ekonomike, dhe realizojnë fitime, i përdorin ato për përmbushjen e

Faqe|9346

qëllimeve të përcaktuara në statut dhe në aktin e themelimit.

Neni 9

Raportimi i rasteve të dyshimta

Organet tatimore të juridiksionit, DRT-të përkatëse i raportojnë rastet e dyshimtat të konstatuara, të përdorimit të OJF-ve për pastrim prash apo financim terrorizmi, “Njesisë qendrore” në DPT sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 16, datë 16.9.2009 të ministrit të Financave “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”.

Njësia qendrore në DPT pasi e vlerëson rastin ia përcjell atë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave në përputhje me përcaktimet e nenit 18 të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit datë parave dhe financimin e terrorizmit”, i ndryshuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi, pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Shkëlqim Cani

URDHËR

Nr. 1957, datë 6.11.2014

PËR MIRATIMIN E MODELIT TË AUTORIZIMIT PËR EKSPORTIN E MBETJEVE DHE MODELIN E AUTORIZIMIT PËR KALIMIN TRANSIT TË MBETJEVE JO TË RREZIKSHME APO INERTE

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 28 shkronja “d” të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar dhe pikës 31 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 641, datë 1.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jot ë rrezikshme e të mbetjeve inerte”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e modelit të autorizimit për eksportin e mbetjeve sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri.



2. Miratimin e modelit të autorizimit për kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme apo inerte sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Ngarkohet Drejtoria e Mjedisit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT
Lefter Koka

SHTOJCA 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr.

Prot.

Tiranë, më . . 2014

AUTORIZIM
PËR EKSPORTIN E MBETJEVE

Në mbështetje të nenit 51 të ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 641, datë 1.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”, miratohet ky autorizim për eksportin e mbetjeve si më poshtë:

1. Personi fizik/juridik “.....”autorizohet të eksportoje nga territori i Republikës së Shqipërisë mbetjet e llojit..... . Këto mbetje do të grumbullohen në ambientet e personit fizik/juridik “.....” në adresën.....dhe trajtimi i tyre përfundimtar do të realizohet në shtetin/et e (sipas destinacionit në pikën 3 më poshtë).

TË DHËNAT E PERSONIT FIZIK/JURIDIK:

Emri: “.....”

Adresa:

NIPT:.....

ADMINISTRATORI/PERSONI KONTAKTT:

Emër Mbiemër:

Tel/Mob:

Email:.....

2. Specifikimet për mbetjet që do të eksportohen nga territori i Republikës së Shqipërisë.

LLOJI I MBETJES	KODI SHIFROR	KODI SIPAS KONVENTËS SË BAZELIT	KODI SIPAS KATALOGUT SHQIPTAR TË MBETJEVE	KODI SIPAS NOMENKLATURËS SË KOMBINUAR TË MALLRAVE	SASIA (TON/VIT OSE COPË)	GJENDJA FIZIKE
.....	AL XYZ /viti kur lëshohet autorizimi					



3. Rrugët që do të ndjekë mbetja dhe destinacioni përfundimtar i mbetjeve

NR.	DEGA DOGANORE E DALJES	VENDI I DALJES	VENDI/ET TRANSIT	DEGA DOGANORE E HYRJES	VENDI I DESTINACIONIT
1.					

4. Masat e nevojshme që duhet të merren për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

-Ambalazhimi që do përdoret për mbetjet (emërtimi i mbetjes) për shmangien e ndotjes së mjedisit është si më poshtë:

a.

b.

-Etiketimi i ambalazheve të mbetjeve, i kontenjerëve dhe mjetit të transportit në një vend të dukshëm të jetë si më poshtë:

a.(Logo, përmasat) ose

b. e pa aplikueshme

-Trajnimi i punonjës/ve që do të realizojnë transportimin e mbetjeve (shoferët etj.) për rrezikun e mbetjeve, masat parandaluese dhe ato veprimet që do të ndërmerren në rast aksidenti.

-Regjistrimi i sasive të mbetjeve që eksportohen dhe të dërgimi i informacionit zyrtar çdo 6 muaj në Ministrinë e Mjedisit, nga data e lëshimit të këtij autorizimi.

5. Afati i autorizimit të eksportit dhe përgjegjësitë ligjore.

1. personi fizik/juridik “.....”mban përgjegjësitë ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 641, datë 1.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte” për eksportin e mbetjeve për të cilat lëshohet ky autorizim.

2. transporti i mbetjeve që nga vendi i daljes deri në vendin e destinacionit nga personi fizik/juridik (emërtimi.....) duhet të shoqërohet me dokumentacionin si më poshtë vijon: (dokumentacioni përcaktohet në varësi të llojit të mbetjes dhe qëllimit të eksportit për rikuperim/asgjësim):

c. Autorizimin për eksport origjinal ose kopje të noterizuar të tij;

d. Dokumentin e lëvizjes të plotësuar sipas aneksit 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 641, datë 1.10.2014;

e. Informacionin sipas aneksit 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 641, datë 1.10.2014.

3. Autorizimi i eksportit të mbetjeve të sipërcituara është i vlefshëm për një afat kohor 1 (një) vjeçar nga data e lëshimit më____/ ____/2014 deri më____/ ____/2015.

MINISTRI I MJEDISIT
Lefter Koka



SHTOJCA 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____

A U T O R I Z I M
PËR KALIMIN TRANSIT TË MBETJEVE JO TË RREZIKSHME APO INERTE

Në mbështetje të nenit 50 të ligjit nr. 10463 datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 641, datë 1.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”, miratohet ky autorizim transiti sipas pikave të përcaktuar si më poshtë:

1. Personi fizik/juridik”.....” autorizohet të transitojë nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë mbetje të llojit

TË DHËNAT E PERSONIT FIZIK/JURIDIK:

Emri: “.....”

Adresa:

ADMINISTRATORI/PERSONI KONTAKTT:

Emër Mbiemër:

Tel/mob:

Email:.....

2. SPECIFIKIMET PËR MBETJET QË DO TË TRANSITOREN NËPËR TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

LLOJI I MBETJES	KODI SHIFROR	KODI SIPAS KONVENTËS SË BAZELIT	KODI SIPAS KATALOGUT SHQIPTAR TË MBETJEVE	KODI SIPAS NOMENKLATURËS SË KOMBINUAR TË MALLRAVE	SASIA (TON/VIT) ose (COPE)	GJENDJA FIZIKE
.....	AL XYZ/viti kur lëshohet autorizimi					

3. RRUGËT QË DO TË NDJEKË MBETJA/ET DHE DESTINACIONI PËRFUNDIMTAR I MBETJEVE

NR.	VENDI I DALJES	VENDI/VENDET TRANSIT	DEGA DOGANORE E HYRJES NË SHQIPËRI	DEGA DOGANORE E DALJES NGA SHQIPËRIA	VENDI I DESTINACIONIT
1.					



4. MASAT E NEVOJSHME QË DUHET TË MERREN PËR MBROJTJEN E MJEDISIT DHE SHËNDETIT TË NJERIUT

-Ambalazhimi që do përdoret për mbetjet (emërtimi i mbetjes) për shmangien e ndotjes së mjedisit të jetë si më poshtë:

- a.
- b.

-Etiketimi i ambalazheve të mbetjeve, i kontenierëve dhe mjetit të transportit të jetë në një vend të dukshëm si më poshtë:

- a. (Logo, përmasat) ose
- b. e paaplikueshme

5. AFATI I AUTORIZIMIT TË TRANSITIT DHE PËRGJEGJËSITË LIGJORE.

-Personi fizik/juridik “.....” mban përgjegjësitë ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 641, datë 1.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte” për transitimin e mbetjeve _____ për të cilin lëshohet ky autorizim.

-Transporti i mbetjeve nga dega doganore e hyrjes në Republikën e Shqipërisë deri në degën doganore të daljes nga Republika e Shqipërisë duhet të shoqërohet me:

- a. Autorizimin për transit origjinal ose kopje të noterizuar të tij;
- b. Dokumentin e lëvizjes të plotësuar sipas aneksit 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 641, datë 1.10.2014;
- c. Informacionin sipas aneksit 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 641, datë 1.10.2014.

-Autorizimi i transitit të mbetjeve të sipërcituara është i vlefshëm për një afat kohor 1 (një) vjeçar nga data e lëshimit më ____/ ____/2014 deri më ____/ ____/2015.

MINISTRI I MJEDISIT
Lefter Koka

VENDIM Nr. 99, datë 7.11.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KESH SHA PËR VITIN 2015

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, vendimit nr. 77, datë 26.6.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.11.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë

elektrike për vitin 2015 dhe relacionin e grupit të punës,

konstatoi se:

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike nga KESH sh.a.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës të prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për vitin 2015.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 100, datë 7.11.2014****FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
FURNIZUESIN PUBLIK ME SHUMICË
(KESH SHA)
PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, vendimit nr. 78, datë 26.6.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.11.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a për përcaktimin e tarifës të energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për vitin 2015 dhe relacionin e grupit të punës,

konstatoi se:

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës të energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë,

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës të energjisë elektrike për aktivitetin e furnizimit publik me shumicë për vitin 2015.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

VENDIM**Nr. 101, datë 7.11.2014****PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“UKKO” SHA, NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA IMPIANTE
FOTOVOLTAIKE ME FUQI 1 MW**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të “rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, VKM-së nr. 196, datë 2.4.2014 “Për miratimin e autorizimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centralit elektrik fotovoltaike të shoqërisë “UKKO” sh.a., Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.11.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “UKKO” sh.a., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impiante fotovoltaike me fuqi 1 MW, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për këtë aplikim,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “UKKO” sh.a, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

-Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

-Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

-Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

-Dokumentacionit teknik : neni 9, pika 4.4.2 (Të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin); l neni 9, pika 4.4.3 (Dokumentacioni teknik dhe grafik); neni 9, pika 4.4.4 (Dokumentacioni tekniko- ekonomik); neni 9, pika 4.4.5 (Leje nga institucione të tjera) është plotësuar në mënyrë korrekte.



Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “UKKO” sh.a., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impiante fotovoltaike me fuqi 1 MW për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 102, datë 7.11.2014

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KOMP.ENERGJI” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “d” të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 13 dhe 14, të “Rregullores për Procedurat e Licencimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Licencave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.11.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Komp.Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Komp.energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

-Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4.10 germa “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Komp.energji” sh.p.k. në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike për një afat 30 vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 103, datë 7.11.2014

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SA’GA-MAT” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 13 dhe 14, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.11.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “SA’GA-MAT” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,



Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “SA’GA-MAT” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

-Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

-Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

-Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

-Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4.10 germat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “SA’GA-MAT” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 104, datë 7.11. 2014

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“EMIKEL” SHPK, NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 13 dhe 14, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës

7.11.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Emikel” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Emikel” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4.10 germat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Emikel” sh.p.k., në aktivitetin e Tregimit të Energjisë Elektrike për një afat 22-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 105, datë 7.11.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “LE
TRADING ALBANIA” SHPK NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të



ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 8 dhe 10 pika 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.11.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Le Trading Albania” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Le Trading Albania” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE. në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10 gerrat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të licencimit të shoqërisë “Le Trading Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 106, datë 7.11.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “AXPO ALBANIA” SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 8 dhe 10 pika 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.11.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “AXPO ALBANIA” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “AXPO ALBANIA” sh.a. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10 gerrat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s



VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të licencimit të shoqërisë “AXPO ALBANIA” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 107, datë 7.11. 2014

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “AXPO ALBANIA” SHA NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË
KUALIFIKUAR TË ENERGJISË
ELEKTRIKE MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE NR. 102, DATË
21.12.2009**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, germa “a”; 9 ; 45 pika “4” dhe 48 pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “P”; 5 pika 1 germa “P”; 13 ; 14 pika 1 dhe 16 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.11.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “AXPO ALBANIA” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “AXPO ALBANIA” sh.a. plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar ,tërësisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b”, “c”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për rinovimin e licencës së shoqërisë “AXPO Albania” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 102, datë 21.12.2009.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 108, datë 14.11.2014

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EFT
ALBANIA” SHPK, NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 13 dhe 14, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.11.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “EFT Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,



konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4.10 germat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “EFT Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 109, datë 14.11. 2014

LICENCIMIN E SHOQËRISË “EFT ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGIJË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, germa “a”; 9 ; 45 pika “4” dhe 48 pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “P”; 5 pika 1 germa “P”; 13 ; 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë

Faqe|9356

9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.11.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “EFT ALBANIA” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “EFT ALBANIA” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b”, “c”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “EFT ALBANIA” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 42 lekë